

R E F E R A T
PËR ZGJEDHJE/RIZGJEDHJE TË NJË MËSIMDHËNËSI PËR LËNDËT

1.SISTEM POLITIK
2. E DREJTA KUSHTETUESE KRAHASUESE

NË FAKULTETIN JURIDIK NË UNIVERSITETIN E TETOVËS

Në lidhje me konkursin për zgjedhje të mësimdhënësve në Universitetin e Tetovës të datës 13.06.2020, të shpallur në gazetën “Koha” dhe “Nova Makedonija” dhe në web faqen zyrtare të Universitetit të Tetovës, për zgjedhjen e një mësimdhënësi për lëndët:

1. Sistem politik dhe
2. E drejta kushtetuese krahasuese

në Fakultetin Juridik të Universitetit të Tetovës, me Propozim të Këshillit Mësimor - Shkencor të Fakultetit Juridik nr 13-488/3 datë 06.07.2020 të datës formohet Komisioni recensues:

- 1. Prof. Dr. Mersim Maksuti, kryetar**
- 2. Prof. Dr. Jusuf Zejneli, anëtar**
- 3. Prof. Dr. Bujar Ahmed, anëtar**

Komisioni recensues, pas shqyrtimit të dokumentacionit në lidhje me konkursin e lartpërmendur dhe në përputhje me nenin 132 të Ligjit për Arsimit të Lartë (“Gazeta Zyrtare e RM-së” nr 82/2018), Statutin e Universitetit të Tetovës, si dhe Rregulloren për kriteret e veçanta dhe procedurën për zgjedhje në thirrje mësimore-shkencore, mësimore, mësimore-profesionale dhe thirrjet e bashkëpunëtorëve në Universitetin e Tetovës, i paraqet Këshillit Mësimor-Shkencor të Fakultetit Juridik dhe Këshillit të Rektoratit të Universitetit të Tetovës këto:

RECENSION

Në konkursin e datës 13.06.2020, të shpallur në gazetën “Koha” dhe “Nova Makedonija” dhe në web faqen zyrtare të Universitetit të Tetovës, për zgjedhjen e një mësimdhënësi për lëndët 1.Sistem politik dhe 2.Edrejta kushtetuese krahasuese, në Fakultetin Juridik të Universitetit të Tetovës, **u paraqit kandidati i vetëm Dr. Driton Kuqi.**

I. BIOGRAFI E SHKURTËR

a. Arsimimi

Në bazë të dokumentacionit të dorëzuar, kandidati Dr. Driton Kuqi është i lindur në Çair të Shkupitku i kryen me sukses të shkëlqyeshëm shkollimin fillor dhe të mesëm, duke u dalluar si nxënës gjenerate! Në vitin 2006 regjistrohet në Fakultetin Juridik të Universitetit FON, të cilin e përfundon në vitin **2009** dhe fiton **titullin Jurist i diplomuar**. Në të njëjtin vit fiton çmimin student gjenerate në nivel Republikan.

Pas përfundimit të studimeve deri-diplomike, Kandidati Dr. Driton Kuqi regjistrohet në studime të magistraturës në Fakultetin Juridik, në **drejtimin kushtetues**. Me temën “Parlamentarizmi në Republikën e Maqedonisë: veprimtaria ligjvënëse dhe kontrolli politik”,

në mentorim të Prof.Dr. Bajram Pollozhanimbron tezën e magjistraturës dhe fiton titullin shkencor **Magjistër i shkencave juridike-drejtimi kushtetues**.

Pas përfundimit të studimeve të magjistraturës Driton Kuqi vijon studimet e doktoraturës në Fakultetin e Drejtësisë në Universitetin “Shën Qirili dhe Metodij”-Shkup, duke i kryer të njejtat me mesatare solide 9.5. Me temën “ Mbi rrënimin e parimit të ndarjes së pushtetit: pushteti ligjvënës vs pushteti ekzekutiv”, në mentorim të Prof.Dr. Gordana Siljanovska-Davkova, mbron tezën e doktoraturës më 19.05.2020 dhe fiton gradën shkencore **“Doktor” në të drejtën kushtetuese**.

b. Angazhimi si ligjërues

Kandidati Dr.Driton Kuqi, angazhohet si asistent i ri në Universitetin FON, ku mbulon ushtrimet nga lëndët: **Historia e së drejtës, Fillet e së drejtës, e drejta kushtetuese, e drejta kushtetuese krahasuese, e drejta administrative**. Pas mbarimit të studimeve të magjistraturës, angazhohet edhe në Fakultetin Juridik – Universiteti i Tetovës, ku mbulon ligjerata dhe ushtrime nga lëndët: **Historia e së drejtës, fillet e së drejtës, e drejta kushtetuese, e drejta kushtetuese krahasuese, qeverisje lokale, sistem politik dhe e drejta administrative**.

II. VEPRIMTARIA SHKENCORE-HULUMTUESE

Kandidati Dr. Driton Kuqi, gjatë gjithë kësaj periudhe merret me publikime në fushën e ekspertizës së tij profesionale. Ai ka publikuar këto punime:

1. “Western and its Engagement in the Balkans”(Ylber Sela, Bekim Maksuti, Driton Kuci) in Mediterranean Journal of Social Sciences, 2015.
2. “Domination of the Government in the political system of the Republic of Macedonia” in “European Scientific Journal”, 2016.
3. “Contemporary Models of organization of power and the Macedonian Model of organization of power”, in European Journal of Interdisciplinary Studies, 2015.
4. “The Infringement of the principle of separation of powers and the domination of the Government in the political system of the Republic of Macedonia”, in the Research Academy of Social Sciences, 2015.
5. “Processes of participation of Republic of Macedonia”, Centrum, 2015.
6. “Relationship between the Legislature and the Executive Power”, Vizione, 2016.
7. “Constitutional –legal engineering of the model of democracy in North Macedonia”, Justicia, 2020.

8.” The post-communist evolution and constitutional-legal engineering of the Macedonian model of democracy “ Conference in at Cambridge University , published in in EJIS, 2020.

4. Pjesëmarrje në konferenca ndërkombëtare dhe të tjera

Për periudhën si asistent-doktorand, ka marrë pjesë në këto konferenca dhe atë:

1. 5-th International Conference in Social Sciences – Prishtinë, 2015.
2. First World Forum for Democracy of the Council of Europe – Strasbourg, 2012.
3. Third Political Academy on Social Democracy, Friedrich Ebert Stiftung.
4. 6-th International Conference on Social Science – Istanbul, 2015.
5. International Conference in Skopje, *Vienna Congress and the Balkans*, 2015.
6. Balkan Benelux, organizer Austrian Economics Center, European for Tax Reform, Alpbach, SEEU and AGREEI, 2013.
7. The Balkans 100 years after the start of the First World War, 2014.
8. Regional Course for Promising Politicians, Alfred Mozer Stichting, Friedrich Ebert Stiftung – Portoroz.
9. Universality, globalization and the rule of Law. Faculty of Law, State University of Tetova, 2015.
10. 4-th International Scientific Conference of the Faculty of Law, state University of Tetova, 2017.
11. 7-th International Conference organized by University of Elbasan “Aleksandër Xhuvani” Toward European Union, Integrating Research and Innovation, 2018.
12. 5- th International Mediterranean Social Sciences Congress (MECAS V), Organized by the University of Donja Gorica and Bandirma Onyedi Eylul University, 2019.
13. Workshop, Electoral Systems Module, organized by Bridge (Building Resources in Democracy, Governance and Elections), 2019.
14. 23-th (ICMS XXIII) International Conference on Multidisciplinary Studies, *Resilience for Survival*, organized at the venue of the Cambridge University, Pitt Building (virtuel) 2020

Ligjerata tjera me ftesë të Akademive vendore dhe ndërkombëtare:

1. Ligjeratë me temë : “*Separation of powers in Macedonia: problems and issues*” held at School of Public Policy “Mother Teresa” part of Council of Europe Network of Schools of Political Studies, generation 2016/2017.
2. Ligjeratë me temë: “*Liderët e rinj*” mbajtur në Akademinë Politike, organizuar nga Qendra Analitike “Abdilaqim Ademi”- Shkup.

III. VEPRIMTARIA MËSIMORE-ARSIMORE

Kandidati Dr. Driton Kuqi, rregullisht, në të dy semestrat të çdo viti akademik, ka mbajtur ligjërata dhe ushtrime në Universitetin e Tetovës edhe atë në Tetovë dhe disperzime në Shkup dhe në Kërçovë, si dhe për dy vite me rradhë ka mbajtur ushtrime ne Universitetin FON në Shkup, Gostivar dhe Strugë.

IV. VEPRIMTARIA ME INTERES MË TË GJERË

Çmime për arritje shkencore:

1. “Shkencëtari i ri i vitit” , çmim i fituar nga FRI.
2. Provim i kaluar me sukses i Jurisprudencës.
3. Provim i kaluar me sukses i Noterisë.

Vizita studimore:

1. Vizitë studimore në Fakultetin Juridik- Universiteti i Oslos
2. Vizitë studimore në Fakultetin Juridik- Universiteti i Krajovës.

Udhëheqës:

1. Ministër i Ekonomisë, në Qeverinë e RMV.
2. Këshilltar ekonomik, nënkryetar në Proektin e Bankës Qendrore Europiane (CEB) për rehabilitimin e Shtëpive të Shëndetit në RMV
3. Koordinator i studimeve të disperzuara të UT në Shkup.

VLERËSIM DHE PROPOZIM

Në bazë të konstatimeve të lartpërmendura, Komisioni recensues vlerëson se kandidati **Dr. Driton Kuqi**, i plotëson të gjitha kushtet ligjore dhe të tjera për zgjedhje në thirrje mësimore *Docent*.

Kandidati Dr. Driton Kuqi ka arsimimin e duhur, ka publikime shkencore të mjaftueshme, ka përvojë në fushën akademike, pjesëmarrje në konferenca ndërkombëtare dhe projekte hulumtuese. Në bazë të kësaj, Komisioni konstaton se Dr. Driton Kuqi, i plotëson të gjitha kushtet për thirrje mësimore *DOCENT*, të parapara në nenin 172-175 të Ligjit për Arsim të Lartë (“Gazeta Zyrtare e RM-së” nr 82/2018), Statutin e Universitetit të Tetovës, si dhe Rregulloren për kriteret e veçanta dhe procedurën për zgjedhje në thirrje mësimore-shkencore, mësimore, mësimore-profesionale dhe thirrjet e bashkëpunëtorëve në Universitetin e Tetovës.

Komisioni recensues, ka nderin t'i propozojë Këshillit Mësimor–Shkencor të Fakultetit Juridik dhe Këshillit të Rektoratit të Universitetit të Tetovës, që **Dr. Driton Kuqi**, të zgjidhet mësimdhënës me thirrje mësimore-shkencore *DOCENT* për lëndët:

1. Sistem politik
2. E drejta kushtetuese krahasuese

Tetovë, 2020

Komisioni recensues

1. Prof. Dr. Mersim Maksuti, kryetar

2. Prof. Dr. Jusuf Zejneli, anëtar

3. Prof. Dr. Bujar Ahmedi, anëtar

S H T O J C Ë
PËR RAPORTIN PËR ZGJEDHJE-RIZGJEDHJE NË THIRRJEN MËSIMORE-
SHKENCORE DHE MËSIMORE-PROFESIONALE

KANDIDATI: DRITON KUQI

INSTITUCIONI: FAKULTETI JURIDIK, UNIVERSITETI I TETOVËS

LËNDËT: 1. SISTEM POLITIK DHE
2. E DREJTA KUSHTETUESE KRAHASUESE

TITULLI: DOCENT

VEPRIMTARIA MËSIMORE-ARSIMORE

Nr. rendor	EMRI I AKTIVITETIT	Pikët
1.	Mbajtja e ligjeratave	
1.1	Historia e së drejtës	3x15x5x0.04=9
1.2	Fillet e së drejtës-studime politike	3x15x3x0.04=5.4
1.3	E drejta kushtetuese krahasuese	3x15x2x0.04=3.6
1.4	Të drejtat e njeriut- Fakulteti ekonomik	2x15x2x0.04=2.4
1.5	Historia nacionale e së drejtës	2x15x5x0.04=6
1.6	Metodologjia e shkrimit juridik (Shkup, Tetovë, Kërçovë)	2x15x1x0.04=1.2x3=2.6
2.	Ushtrime (UT+FON)	
Organ hhdhujh	Historia e së drejtës	1x15x5x0.03=2.2
Marrëdhënie n	Historia nacionale e së drejtës	1x15x5x0.03=2.2
Jhdhdhdhdhdhh	Fillet e së drejtës	2x15x5x0.03=4.5
2.4	E drejta kushtetuese	2x15x5x0.03=4.5
Historia e së dr	Fillet e së drejtës- studime politike	2x15x4x0.03=3.6
2.6	E drejta administrative	2x15x5x0.03=4.5
	E drejta kushtetuese krahasuese	1x15x4x0.03=1.8
2.8	Metodologjia e shkrimit juridik	1x15x1x0.03=0.45 x3 =1.35
2.9	Të drejtat e njeriut- Fakulteti Ekonomik	1x15x20.03=0.9
2.10	Historia e së drejtës (FON- Shkup, Gostivar, Strugë)	2x15x2x0.03=1.8x3=5.4
2.11	Fillet e së drejtës (FON-Shkup, Gostivar, Strugë)	2x15x2x0.03=1.8x3=5.4
2.12	E drejta administrative (FON- Shkup, Gostivar, Strugë)	2x15x2x0.03=1.8x3=5.4
2.13	E drejta Kushtetuese (FON- Shkup, Gostivar, Strugë)	2x15x2x0.03=1.8x3=5.4
2.14	Vetqeverisje lokale (FON- Shkup, Gostivar, Strugë)	2x15x2x0.03=1.8x3=5.4
	Gjithsej	82.85

VEPRIMTARIA SHKENCORE-HULUMTUESE

Nr. Rendor	EMRI I AKTIVITETIT	Pikët
1.	PJESËMARRJA NË KONFERENCA SHKENCORE DHE SIMPOZIUME NACIONALE DHE NDËRKOMBËTARE	
1.1	5-th International Conference in Social Sciences – Prishtinë, 2015.	3.0
1.2.	First World Forum for Democracy of the Council of Europe – Strasbourg, 2012	3.0
1.3.	Third Political Academy on Social Democracy, Friedrich Ebert Stiftung.	3.0
1.4.	6 – th International Conference on Social Sciences- Istanbul.	3.0
1.5.	International Conference, <i>Vienna Congress and the Balkans, 200 years later</i> , Skopje.	3.0
1.6.	International Conference, <i>Balkan Benelux, 200 years later</i> , organized by Austrian Economics Center, European for Tax Reform, Alpbach, SEEU, and AGREEI	3.0
1.7	Regional Course for Promising Politicians, Alfred MozerStichting, Friedrich Ebert Stiftung, Portoroz.	3.0
1.8	International Conference, <i>Universality, Globalization and the Rule of Law</i> , organized by State University of Tetova	3.0
1.9	4-th International Scientific Conference of the Faculty of Law, organized by State University of Tetova	3.0
1.10	7-th International Conference, <i>Toward European Union, Integrating Research and Innovation</i> , organized by University of Elbasan “ Aleksandër Xhuvani”, Elbasan	3.0
1.11	Workshop, <i>Civil and Contemporary Security Challenges</i> , organized by ESJ (Ecole Superieure De Journalisme- Paris)	3.0
1.12	5- th International Mediterranean Social Sciences Congress (MECAS V), organized by University of Donja Gorica and Bandirma Onyedi Eylul University	3.0
1.13	Workshop, Electoral Systems Module, organized by Bridge (Building Resources in Democracy, Governance and Elections	3.0

1.14	23-th (ICMS XXIII) International Conference on Multidisciplinary Studies, <i>Resilience for Survival</i> , organized at the venue of the Cambridge University, Pitt Building (virtuel)	3.0
	SHKENCORE/PROFESIONALE, TË PUBLIKUARA NË KONFERENCA NDËRKOMBËTARE ME PROCEEDINGS ME BORD REDAKTUES NDËRKOMBËTAR, NË REVISTA NDËRKOMBËTARE SI DHE NË REVISTA ME IMPAKT FAKTOR	
3	ARTIKUJ ME REZULTATE ORIGJINALE	
3.1.	Ylber Sela, Bekim Maksuti, Driton Kuqi, <i>Western and its Engagement in the Balkans</i> , in <i>Mediterran Journal of Social Sciences</i> , MCSER Publishing, Vol 6. No.2 S 5, Rome-Italy	6.0
3.2.	Driton Kuqi, <i>Domination of the Government in the political system of the Republic of Macedonia</i> , in <i>European Scientific Journal</i> , Edition volume.11, No 22	6.0
3.3.	DritonKuqi, <i>Contemporary Models of organization of power and the Macedonian Model of organization of power</i> , in <i>European Journal of Interdisciplinary Studies</i> , volume 1, Issues 3	6.0
3.4.	DritonKuqi, PishtarLutfiu, <i>Processes of Participation of Republic of Macedonia</i> , <i>Centrum</i>	6.0
3.5.	Driton Kuqi, <i>Relationship between the Legislative and Executive power</i> , <i>Vizione</i>	6.0
3.6.	Driton Kuqi, <i>The infrigment of the principle of separation of power and the domination of the Government in the political system of the Republic of Macedonia</i> , in the <i>Research Academy of Social Sciences</i> vol. 3(3)	6.0
3.7.	DritonKuqi,NjomzaSelimi Osmani, <i>Constitutional-legal engineering model of democracy in North Macedonia</i> , in <i>Justicia</i>	6.0
3.8	DritonKuqi, <i>The post – Communist Evolution and Constitutional-legal Engineering of the Model of Democracy in North Macesonia</i> , in <i>European Journal of Interdisciplinary Studies</i> , Vol.7. No.1	6.0
4	Ligjerata tjera me ftesë të Akademive vendore dhe ndërkombëtare:	
4.1	Ligjeratë me temë : “ <i>Separation of powers in</i>	3

	<i>Macedonia: problems and issues</i> ” held at School of Public Policy “Mother Teresa” part of Council of Europe Network of Schools of Political Studies, generation 2016/2017.	
4.2	Ligjeratë me temë: “ <i>Liderët e rinj</i> ” mbajtur në Akademinë Politike, organizuar nga Qendra Analitike “Abdilaqim Ademi”- Shkup.	2
	Gjithsej	95

VEPRIMTARI ME INTERES MË TË GJERË

Nr. Rendor	EMRI I AKTIVITETIT	Pikët
1.	ÇMIME PËR ARITJE SHKENCORE	
1.1	Fitues i çmimit “Shkencëtari i ri i Vitit”	5.0
1.2	Provimi i Jurisprudencës	5.0
1.4	Provimi i noterisë	5.0
2.	VIZITË STUDIMORE	
2.1	Vizitë studimore në Fakultetin Juridik- Universiteti në Oslo, Norvegji	1.0
2.2	Vizitë studimore në Fakultetin Juridik- Universiteti i Krajovës, Romani	1.0
3.	UDHËHEQËS	
3.1	Ministër i Ekonomisë në Qeverinë e RMV	3.0
3.2	Koordinator i studimeve të disperzuara të UT në Shkup	3.0
3.3	Këshilltar ekonomik, nënkryetar në Proektin e Bankës Qendrore Europiane (CEB) për rehabilitimin e Shtëpive të Shëndetit në RMV	3.0
	GJITHSEJ	26

REFERENCAT PROFESIONALE TË KANDIDATIT PËR ZGJEDHJE NË THIRRJEN	Pikët
VEPRIMTARIA MËSIMORE-ARSIMORE	82.85

VEPRIMTARIA SHKENCORE-HULUMTUESE	95
VEPRIMTARITË ME INTERES MË TË GJERË	26
GJITHSEJ	203.85

Tetovë, 2020

Komisioni recensues

1. Prof. Dr. Mersim Maksuti, kryetar

2. Prof. Dr. Jusuf Zejneli, anëtar

3. Prof. Dr. Bujar Ahmedi, anëtar

Deri te:
- KËSHILLI MËSIMOR-SHKENCOR
I FAKULTETIT JURIDIK
UNIVERSITETI I TETOVËS
- SENATI I UNIVERSITETIT TË TETOVËS

R E F E R A T

PËR ZGJEDHJE TË MËSIMDHËNËSIT NË THIRRJE MËSIMORE-SHKENCORE
PROFESOR INORDINAR NË PROGRAMIN STUDIMOR STUDIMET E DREJËSISË NË
FAKULTETIN JURIDIK TË UNIVERSITETIT SHTETËROR TË TETOVËS

Me vendim të Këshillit mësimor-shkencor të Fakultetit Juridik të Universitetit të Tetovës, me nr.22-648/1 të datës 28.05.2020, dhe në bazë të konkursit të shpallur më: 13.06.2020 në gazetën ditore “Koha” dhe “Nova Makedonija” dhe Web faqen e Universitetit të Tetovës, Këshillit Mësimor - Shkencor i Fakultetit Juridik solli Vendim nr. 13-448/3 të datës 06.07.2020 për formimin e Komisionit recensues për zgjedhjen e një mësimdhënësi në thirrje mësimore-shkencore, profesor inordinar për lëndët mësimore:

E drejta e procedures penale,
Metodologjia e shkrimit juridik dhe
Psikologjia kriminalistike.

Komisioni recensues në përbërje:

1. Prof. dr. Naser Ademi, (kryetar), profesor ordinar në Fakultetin Juridik të Universitetit Shtetëror të Tetovës;
2. Prof. dr. Qebir Avziu, (anëtar), profesor inordinar në Fakultetin Juridik të Universitetit Shtetëror të Tetovës;
3. Prof. dr. Afrim Osmani, (anëtar), profesor inordinar në Fakultetin Juridik të Universitetit Shtetëror të Tetovës;

Komisioni i lartpërmendur pasi që i pranoi materialet e dorëzuara në konkurs, titullit të lartpërmendur i paraqet këtë:

R A P O R T

Në bazë të propozimit të Këshillit Mësimor-Shkencor të Fakultetit Juridik, të Universitetit Shtetëror të Tetovës, lidhur me Konkursin, për zgjedhjen-rizgjedhjen e mësimdhënësve në të gjitha thirrjet mësimore-shkencore në Universitetin e Tetovës të datës 13.06. 2020, të shpallur në të përditshmen: "Koha", "Нова Македонија", dhe në Web faqen zyrtare të Universitetit të Tetovës www.unite.edu.mk, për zgjedhjen-rizgjedhjen e një mësimdhënësi në thirrjen mësimore shkencore **Profesor inordinar** për lëndët: "**E drejta e procedures penale**", "**Metodologjia e shkrimit juridik**" dhe "**Psikologjia kriminalistike**" në **Fakultetin Juridik të Universitetit Shtetëror të Tetovës**, u paraqit vetëm një kandidat,

Doc.dr. Fatbardha Ismaili e punësuar në marrëdhënie të rregullt pune, si Docent në Fakultetin Juridik të Universitetit të Tetovës.

I. TË DHËNA BIOGRAFIKE DHE ZHVILLIMI PROFESIONAL

A. Të dhënat themelore

Në bazë të dokumentacionit të dorëzuar, kandidatja Dr. Fatbardha Ismaili ka lindur më 06.11.1981 në Gostivar. Shkollimin fillor e ka kryer në Sh.f “Vllazrim Bashkimi” në Gostivar, në vitin 1996. Shkollën e mesme e ka mbaruar në Sh.Q.M “Nikolla Shtejn” në Tetovë në vitin 2000, ku edhe zgjidhet nxënësja më e mirë e gjeneratës. Në vitin akademik 2000/2001 u regjistrua në Fakultetin Juridik pranë Universitetit “Shën Kirili dhe Metodi” në Shkup, ku studimet juridike katervjecare i mbaroi një vit akademik para kohe në vitin 2003 dhe e morri titullin Jurist i Diplomuar.

Pas përfundimit të studimeve universitare të drejtësisë, kandidatja më 25.11.2003 i filloi studimet e Magjistraturës në Fakultetin Juridik pranë Universitetit “Shën Kirili dhe Metodi” në Shkup. Pas përfundimit të provimeve të parapara, kandidatja e paraqiti temën e magjistraturës: “Mjetet e jashtzakonshme juridike në procedurën penale” nën mentorimin e Prof. Dr. Gordana Buzharovska- Lazhetiq. Temën e paraqitur e mbrojti publikisht më 11.03.2011 para Komisionit treanëtarësh të përbërë nga Prof. Dr. Nikolla Matovski - kryetar, Prof. Dr. Gordana Buzharovska- Lazhetiq dhe Doc. Dr. Lazar Nanev - anëtar, dhe mori titullin Magjistër i Shkencave Juridike.

Studimet e Doktoraturës i vijoi poashtu në Fakultetin Juridik pranë Universitetit “Shën Kirili dhe Metodi” në Shkup. Në mbledhjen e mbajtur më 29.06.2011, Këshilli mësimor-shkencor ia pranoi propozimin e parashtruar për punimin e temës së doktoraturës më temë: “Zbatimi i masës së paraburgimit në aspekt të nenit 5 të Konventës Evropjane për të Drejtat e Njeriut”, nën mentorimin e Prof. Dr. Gordana Buzharovska- Lazhetiq. Ku më 09.06.2015 me sukses e mbrojti disertacionin e doktoratës, me të cilën e fitoi gradën shkencore akademike *Doktor i shkencave juridike*.

Kandidatja njëkohësisht dhe paralelisht regjistrohet në studimet e doktoraturës në Tiranë në vitin 2011 ku me sukses të lartë i mbaroi provimet e doktoraturës. Në mbledhjen e mbajtur më 18.10.2011, Këshilli mësimor-shkencor ia pranoi propozimin e parashtruar për punimin e temës së doktoraturës më temë: “Gjykimi në kohë të arsyeshme në realitetin vendorë dhe atë rajonal”, nën mentorimin e Prof. Dr. Xhezair Zaganjori. Kandidatja Fatbardha Ismaili pas prezentimit disa herë të pjesëve të temës së disertacionit para komisionit është në përfundim e sipër të temës së paraqitur.

Kandidatja Dr. Fatbardha Ismaili nga 11.02.2004 - 08.09.2007 ka punuar në Zyrën e Kryqit të Kuq Amerikan (American Red Cros) në Shkup si zyrtare për projektet në sferën e mbrojtjes së të drejtave të fëmijëve. Në Zyrën e Kryqit të Kuq Amerikan (American Red Cros) në Shkup, Fatbardha Ismaili ka punuar në: 1. Zgjedhjen e projekteve; 2. Kampanjat Informative; 3. Organizimin e seminareve; 4. Ligjërime në seminare.

Nga viti 2007, me vendim nga Komisioni Amë për themelimin të Universitetit Shtetëror të Tetovës, Fatbardha Ismaili është e punësuar në Fakultetin Juridik pranë Universitetit Shtetëror të Tetovës si Asistente e Re, ku ka mbajtur ushtrime në lëndët: E drejta e procedurës penale, E drejta penale (pjesa e përgjithshme dhe e vecantë), Kriministikë, E drejta ekologjike, Historija e së drejtës nacionale, E drejta kushtetuese, Fillet e së drejtës, E drejta administrative si dhe nga lënda Sociologjia e së drejtës.

B. Marrja e thirrjeve mësimore

2007 - 2012: u zgjodh **Asistent i Ri** në Fakultetin Juridik pranë Universitetit Shtetëror të Tetovës, programi studimor: studimet e drejtësisë.

2012: – u zgjodh **Asistent** (bashkëpunëtor) në Fakultetin Juridik pranë Universitetit Shtetëror të Tetovës.

2015: u zgjodh **Docent** në Fakultetin Juridik pranë Universitetit Shtetëror të Tetovës për lëndët : "E drejta e procedurës penale" dhe "Metodologjia e shkrimit juridik".

II. VEPRIMTARIA MËSIMORE-ARSIMORE

A. Mbajtja e mësimit

Gjatë viteve akademike të periudhës 2015-2020 në Fakultetin Juridik Doc.dr. Fatbardha Ismaili ka ligjëruar lëndët në ciklin e parë të studimeve: Metodologjia e shkrimit juridik, E drejta e procedurës penale, Bazat e sistemit gjyqësor, Taktika kriminale, E drejta ekologjike, Kriminologjia dhe Psikologjia kriminale.

Në të njëjtën periudhë kohore kandidati ka ligjëruar këto lëndë në studimet e ciklit të dytë: E drejta penale ndërkombëtare, Metodologjia e hulumtimit shkencor, Metodologjia e hulumtimit shkencor në shkencat politike.

Në përputhje me Rregulloren dhe procedurën për zgjedhjen në thirrjet mësimore-shkencore, mësimore-profesionale dhe thirrjeve për bashkëpunëtor në Universitetin e Tetovës (Buletini i universitetit), kandidatja Doc.dr. Fatbardha Ismaili ka realizuar gjithsej 177.41 pikë nga veprimtaria mësimore-arsimore.

III. VEPRIMTARIA KËRKIMORE-SHKENCORE

Përveç angazhimit të rregullt në procesin mësimor, Doc.dr. Fatbardha Ismaili në vazhdimësi është angazhuar në veprimtarinë kreative kërkimore-shkencore në fushën e drejtësisë. Dëshmi për punën kualitative kërkimore-shkencore të kandidatës janë, gjithsesi punimi i magistraturës dhe disertacioni i doktoratës, si dhe aritja në perfundim të sipërm të doktoraturës së dytë të cilët i plotësojnë kriteret më të larta të punës kërkimore-shkencore dhe akademike.

Kandidatja ka marrë pjesë në shumë konferenca vendore dhe ndërkombëtare, nga të cilat edhe ka publikuar shumë punime në revistat dhe buletinet shkencore vendore dhe ndërkombëtare. Të gjitha këto segmente të veprimtarisë shumëdimensionale të paraqitura nga veprimtaria mësimore-shkencore dhe kërkimore-shkencore sublimohen përmes përvojës arsimore-aplikative në procesin e realizimit të veprimtarisë arsimore të kandidatës në Universitetin Shtetëror të Tetovës.

Veprimtarinë kërkimore-shkencore të kandidatës e përbëjnë punimet shkencore të publikuara në revista shkencore ndërkombëtare, me pjesëmarrjen në tubime shkencore ndërkombëtare dhe pjesëmarrjen në projekte nacionale. Këto aktivitete të kandidatës paraqiten në vazhdim.

III /A . Punimet shkencore

Vazhdon lista e punime të publikuara kërkimore-shkencore:

- F. Ismaili „Extraordinary legal remedies based on the provisions of code of criminal procedure in the Republic of Macedonia”, SEEU review, volume 8, No. 2, 2012, DOI: 10.2478/v 10306-012-6.
- F. Ismaili „The cloning and its ethical –legal implications”, UNESCO Chair in Bioethics, Medical Ethics and Health Law, Npeles, Italy, 2013.
- M.Dauti, L.Malaj, B.Dauti, F.Ismaili, „Moral and legal responsibilities-dilemmas faced in pharmacy-experiences from the Republik of Macedonia” UNESCO Chair in Bioethics, Medical Ethics and Health Law, Npeles, Italy, 2013.
- F. Ismaili „Genocide-That magic word!”, The Law and Practice of the International Criminal Court: Achievements, Impact and Challenges-March, 2013 Tirana.
- F. Ismaili „Gjykata ndërkombëtare penale (GJNP) - percaktimi i gjenocidit”, JUSTICIA, Nr. 2, 2014 Tetovë.
- F. Ismaili „Respect the law of personal freedom and security in rule of law”, JUSTICIA, Nr. 3, 2015 Tetovë.
- F. Ismaili „Fair trial and its application in the Republic of Macedonia”, proceedings book ICSS 2015, volume II, Bucharest, 2015.
- F. Ismaili „Principle of reasonable time in criminal proceedings”, Academic journal of Justice and Law (AJJL), SKAP Journals, Slovakia 2015, with impact factor 0.43, ISSN 1946-4699.
- F.Ismaili „Duration of detention in the light of international standards, domestic law and case law,, International Journal of Legal Sciences JUSTICIA, No. 9, Vol.6. 2018
- F.Ismaili „Security of Integrity of Witnesses and Justice Collaborators,, International Journal of Legal Sciences JUSTICIA, No.10 Vol.6, 2018
- F.Ismaili „Mbrojtja e dëshmitarëve në Republikën e Maqedonisë,, Book of Proceedings ISBN- 978-9951-494-80-9, Kolegji AAB, Prishtinë, 2018.
- F.Ismaili „Comparative examination of the witness protection,, International Journal of Legal Sciences, JUSTICIA, No.12 Vol.7. 2019

- F.Ismaili „The Principle of Equality of Arms in the Jurisprudence of the European Court of Human Rights, Book of Proceedings CUCC2018, BAU, 2018, Tetova.
- F.Ismaili „Witness Protection of Kosovo from the Aspects of Human Rights, Book of Proceedings CUCC2019, BAU, 2019, Thessaloniki, Grece.
- F.Ismaili „Witness Protection in the Republic of Kosovo - Core Problem Causes,, International Journal of Legal Sciences, JUSTICIA, No. 13. Vol. 8 (në botim).
- Metodologjia e shkrimit juridik Tetovë, 2019, Libër Universitar.

B. Tubime shkencore

- Seminari veror ne Bulgari : Instituti per Ekonomi te tregu , Sofie, 14-20 Korik, 2006;
- Konference Nderkombetare e Studiuesve te Rinj ne Drejtësi „ Te drejtat e njeriut” 18-19 Maj Tiranë, 2011;
- Konferenca Shkencore Ndërkombëtare , “Shteti dhe drejtësia shqiptare në 100 vjet panvarsi” , 17 Maj 2012, Tiranë;
- Konferenca Shkencore Ndërkombëtare “Arsimi i lartë, masivizimi dhe sfidat e tij drejt integritimit evropjan” Tiranë, 26 – 27 tetor, 2012;
- Konference Shkencore Nderkombtare “Sfidat rajonale te sigurise njerezore” 2 qershor 2012, Tiranë.
- F. Ismaili, Implementation of detention in the republic of Macedonia, Second International Scientific Conference “Univertyalitzzy, Globalization and the rule of law” 13-14 November 2015, at University of Tetova, Macedonia.
- F.Ismaili, Duration of Detention in the Light of International Standards, Domestic Law and Case Law, 3th International Scientific Conference „ The law and Challenges of the Euro- Atlantic Processes,, 18-19 November 2016, at University of Tetova, Macedonia.
- F.Ismaili, Witness Protection in the Republic of Kosovo - Core Problem Causes, 6th International Scientific Conference “European Perspective of the Western Balkans” 13-15 November 2019 at University of Tetova, Macedonia.
- F.Ismaili, Mbrojtja e dëshmitarëve në Republikën e Maqedonisë, Konferencë Shkencore Ndërkombëtare „Konsolidimi i Shtetit dhe Sfidat Eurointegruese,, 15-16 Shkurt, 2018 Kolegji AAB , Prishtinë.
- F.Ismaili, Security of Integrity of Witnesses and Justice Collaborators 4th International Scientific Conference „Security Challenges and Universal Standards in the Euro-Atlantic Integration Process,, 17-18 November 2017, at University of Tetova, Macedonia.
- F.Ismaili, Comparative examination of the Witness Protection, 5th International Scientific Conference „The rule of law and civil society,, 19-20 October 2018, at University of Tetova, Macedonia.
- F.Ismaili, The Principle of Equality of Arms in the Jurisprudence of the European Court of Human Rights, 4th Annual Conference of the Balkan Universities Association „Collaboration between universities and cultural coexistence a premiose for a sustainable platform in overall Balkan area,, 30-31- March, 2018, University of Tetova, Macedonia.

- F.Ismaili, HER 2 positive - the rights of those affected, HER 2 positive - the rights of those affected, Global Health Catalyst Summit held at Harvard School, Boston May 24 – 26, 2019
- F.Ismaili „Witness Protection of Kosovo from the Aspects of Human Rights, 5 th Annual Meeting Balkan Universities association Conference, Thessaloniki, April 16-18, 2019, Grece.
- F. Ismaili „Cybercrime And Its Effects On The Youths And The Future Planning,, 7th International Student Congress, Maltepe University,9-10 May, 2019.
- International Conference, Bringing Western Balkans Closer to EU:Economic, Social, Political, Legal and Technological Considerations 27-29 April 2020 Prishtina.
- Workshop "Justice for children in the anti-terrorist context" Promotion of the Memorandum of Understanding on Juvenile Justice in the context of the fight against terrorism at the Global Anti-Terrorism Forum (GTFC) Veles, 19.04.2019.
- Twelfth International Conference On: “Education And Social Sciences – Global Challenge 2020” 11.April 2020.
- 20th International Conference on Social Sciences in Zurich, on 6-7 September 2019, Zurich University.
- Tendencije razvoja u obveznom pravu na 40. godišnjicu Zakona o obveznim odnosima 15.–16. studenoga 2018. Pravni fakultet Sveučilišta u Ljubljani
- Konferencën Ndërkombëtare “Pabarazitë Shoqërore: Veçori, Sfida Dhe Perspektiva” Departamenti I Sociologjisë Fakulteti I Shkencave Sociale Universiteti I Tiranës Tiranë, 07 Nëntor 2017.

Në përputhje me Rregulloren dhe procedurën për zgjedhjen në thirrjet mësimore-shkencore, mësimore-profesionale dhe thirrjeve për bashkëpunëtor në Universitetin eTetovës (Buletini i universitetit), kandidatja Doc.dr. Fatbardha Ismaili ka realizuar gjithsej 188 pikë nga veprimtaria shkencore-hulumtuese.

VEPRIMTARIA PROFESIONALE-APLIKATIVE

- Prezantimi i ofertës akademike të Universitetit të Tetovës në shkollat e mesme në vitin akademik 2015/2016
- Prezantimi i ofertës akademike të Universitetit të Tetovës në shkollat e mesme në vitin akademik 2016/2017
- Pjesmarje në realizimin e aktivitetit: Ditët e hapura të UT, Fakulteti Juridik, 2016
- Pjesmarje në realizimin e aktivitetit: Ditët e hapura të UT, Fakulteti Juridik, 2017
- Pjesmarje në realizimin e aktivitetit: Ditët e hapura të UT, Fakulteti Juridik, 2018
- Pjesmarje në realizimin e aktivitetit: Ditët e hapura të UT, Fakulteti Juridik, 2019
- Pjesmarje në realizimin e aktivitetit: Ditët e hapura të UT, Fakulteti Juridik, 2020

Në përputhje me Rregulloren dhe procedurën për zgjedhjen në thirrjet mësimore--shkencore, mësimore-profesionale dhe thirrjeve për bashkëpunëtor në Universitetin eTetovës (Buletini i universitetit), kandidatja Doc.dr. Fatbardha Ismaili ka realizuar gjithsej 7.00 pikë nga veprimtaria profesionale-aplikative.

VEPRIMTARITË ME INTERES MË TË GJERË

- **Këshilli redaktues i revistës shkencore/profesionale ndërkombëtare**
- „Justicia”- International journal of legal sciences, ISSN: 1857-8454. botim i Fakultetit Juridik, Universiteti i Tetovës.
- **Kryetari i bordit organizativ ose programor të një takimi shkencor / profesional ndërkombëtar**
- 4th International Scientific Conference „Security Challenges and Universal Standards in the Euro- Atlantic Integration Process,, 17-18 November 2017, at University of Tetova, Macedonia.
- 5th International Scientific Conference „The rule of law and civil society,, 19-20 October 2018, at University of Tetova, Macedonia.
- 6th International Scientific Conference “European Perspective of the Western Balkans” 13-15 November 2019 at University of Tetova, Macedonia.
- Konferenca Shkencore Ndërkombëtare “Sfidat rajonale te sigurise njerezore” 2 qershorë 2015, Tiranë.
- Prodekan për Shkencë, Fakulteti Juridik, Universiteti i Tetovës, 2017 – vazhdon
- Anëtar i komisionit qendror për evaluim në Universitetin e Tetovës, 2015.
- Anëtar i komisionit për evaluim në kuadër të Fakultetit Juridik, Universitetin e Tetovës, 2015.
- Anëtar i komisionit për verifikimin e provimeve dhe notave të të diplomuarve në fakultetin Juridik 2018
- Anëtar i komisionit për verifikimin e dosjeve të studentëve të diplomuar të Fakultetit Juridik 2016
- Member of the international forum of Teachers (IFT) 2015
- Anëtar i këshillit mësimor shkencor, të Fakultetit Juridik 2015.
- Anëtar i komisionit për hartimin e elaboratit për programet studimore të dtudimeve të drejtësisë, gazetari dhe media, kriminalistikë dhe studime politike 2018.
- **Anëtar i grupit të punës për pregaditjen e legjislacionit**
- Anëtar i grupit të punës për pregaditjen e propozim ligjit për mbrojtjen e dëshmitarëve, Ministrisa e Drejtësisë RMV, 2017.
- ARC Training lidership - voluntery counseling for patients rights-Sofia 2015.
- Erasmus staf mobility for training programe 2018/2019

Në përputhje me Rregulloren dhe procedurën për zgjedhjen në thirrjet mësimore-shkencore, mësimore-profesionale dhe thirrjeve për bashkëpunëtor në Universitetin eTetovës (Buletini i universitetit), kandidatja Doc.dr. Fatbardha Ismaili ka realizuar gjithsej 57 pikë nga veprimtaritë me interes më të gjërë.

IV. Formulari për raportin për zgjedhje në thirrjen mësimore-shkencore

Në shtojcë e bashkangjesim formularin për raportin e zgjedhjes në thirrjen mësimorëshkencore. Kandidatja Doc.dr. Fatbardha Ismaili ka gjithsej 429.41 **pikë**, edhe atë për: veprimtarinë mësimore-arsimore – 177.41 **pikë**, veprimtarinë shkencore-hulumtuese –

188.00 pikë, veprimtarinë profesionale-aplikative – 7.00 pikë dhe veprimtaritë me interes më të gjerë – 57.00 pikë.

REFERENCAT PROFESIONALE TË KANDIDATIT PËR ZGJEDHJEN NË THIRRJE	Pikë
VEPRIMTARIA MËSIMORE-SHKENCORE	177.41
VEPRIMTARIA SHKENCORE-HULUMTUESE	188.00
VEPRIMTARIA PROFESIONALE-APLIKATIVE	7.00
VEPRIMTARITË ME INTERES MË TË GJERË	57.00
Gjithsejt	429.41

PËRFUNDIMI DHE PROPOZIMI

Në bazë të pasqyrës së prezantuar më lartë të aktiviteteve në veprimtaritë mësimorearsimore, shkencore-hulumtuese, profesionale-aplikative dhe veprimtarive me interes më të gjerë, Komisioni konstaton se kandidatja Doc. dr. Fatbardha Isni Ismaili në përputhje me Rregulloren për kriteret dhe procedurën për zgjedhje në thirrjet mësimore-shkencore, shkencore, mësimore-profesionale dhe të bashkëpunëtorit në Universitetin Shtetëror të Tetovës (Buletini I universitetit), ka tubuar gjithsej 429.41 pikë nga referencat profesionale dhe me këtë e ka kaluar numrin minimal të pikëve që duhet të realizohen për zgjedhjen në thirrjen mësimore-shkencore **Profesor Inordinar**.

Duke pasur parasysh atë që u paraqit më lartë, Komisioni recensues ka nderin dhe kënaqësinë t'i propozojë Këshillit të Rektoratit të Universitetit Shtetëror të Tetovës që kandidatja Doc.dr. Fatbardha Isni Ismaili të zgjidhet në thirrjen mësimore-shkencore **PROFESOR INORDINAR** për lëndët: **E drejta e procedurës penale dhe Metodologjia e shkrimit juridikt** dhe Psikologjia Kriminalistike, në studimet e drejtësisë Fakulteti Juridik.

Tetovë, 2020

KOMISIONI RECENSUES

1. Dr. Naser Ademi, profesor ordinar, – kryetar

2. Dr. Qebir Avziu, profesor inordinar, - anëtar

3. Dr. Afrim Osmani, Profesor inordinar, anëtar

S H T O J C Ë

PËR RAPORTIN PËR ZGJEDHJEN NË THIRRJEN MËSIMORE-SHKENCORE, SHKENCORE DHE MËSIMORE-PROFESIONALE

Kandidati: Fatbardha Isni Ismaili

(emri, emri i prindërit dhe mbiemri)

Institucioni: Fakulteti Juridik – USHT, Tetovë _____

(emri i fakultetit/institutit)

Lëmia Shkencore: Studimet e drejtësisë

VEPRIMTARIA MËSIMORE-ARSIMORE

Nr.	Emri i aktivitetit:	Aktiviteti i realizuar				Pikët
		Pikët	Fondi	Javët	Sem.	
1.	Mbajtja e ligjëratave (cikli i parë i studimeve)					46.8
1.1	Metodologjia e shkrimit juridik	0.04	2	15	5	6
1.2	Metodologjia e shkrimit juridik (studimet e disperzuara)	0.04	2	15	5	6
1.3	E drejta e procedurës penale (studimet e disperzuara)	0.04	3	15	3	5.4
1.4	Bazat e sistemit gjyqësor	0.04	2	15	3	3.6
1.5	E drejta e procedurës penale (kriminalistik)	0.04	3	15	5	9
1.6	Taktika kriminalistike 1	0.04	2	15	3	3.6
1.7	E drejta ekologjike	0.04	2	15	1	1.2
1.8	Kriminaliteti ekologjik	0.04	2	15	5	6
1.9	Psikologjia kriminalistike	0.04	2	15	5	6
2	Mbajtja e ligjëratave (cikli i dytë i studimeve)	Pikët	Fondi	Javët	Sem.	12
2.1	E drejta penale ndërkombëtare	0.05	2	10	2	2
2.2	Metodologjia e hulumtimit shkencor	0.05	2	10	5	5
2.3	Metodologjia e hulumtimit shkencor (shkencaat politike)	0.05	2	10	5	5
3.	Mbajtja e ushtrimeve (lëndët në ciklin e parë të studimeve)	Pikët	Fondi	Javët	Sem.	32.4
3.1	Metodologjia e shkrimit juridik	0.03	2	15	5	4.5
3.2	Metodologjia e shkrimit juridik	0.03	2	15	5	4.5

	(studimet e disperzuara)					
3.3	E drejta e procedures penale (studimet e disperzuara)	0.03	2	15	3	2.7
3.4	Bazat e sistemit gjyqësor	0.03	2	15	3	2.7
3.5	E drejta e procedurës penale (kriminalistik)	0.03	2	15	5	4.5
3.6	Taktika kriminalistike 1	0.03	2	15	3	2.7
3.7	E drejta ekologjike	0.03	2	15	2	1.8
3.8	Kriminaliteti ekologjik	0.03	2	15	5	4.5
3.9	Psikologjia kriminalistike	0.03	2	15	5	4.5
4	Konsultime me studentë	4.71				
4.1.	Metodologjia e shkrimit juridik	60x5x0.002=0.6				
4.2.	Metodologjia e shkrimit juridik (studimet e disperzuara)	60x5x0.002=0.6				
4.3.	E drejta e procedures penale (studimet e disperzuara)	60x3x0.002=0.36				
4.4.	Bazat e sistemit gjyqësor	95x3x0.002=0.57				
4.5.	E drejta e procedurës penale	90x5x0.002=0.9				
4.6.	Taktika kriminalistike 1	60x3x0.002=0.36				
4.7.	E drejta ekologjike	60x1x0.002=0.12				
4.8	Kriminaliteti ekologjik	60x5x0.002=0.6				
4.9	Psikologjia kriminalistike	50x5x0.002=0.6				
5.	Përgatitja e lëndës së re	17.5				
5.1	Ligjërata					
5.1.1	E drejta e procedurës penale	1				
5.1.2	Metodologjia e shkrimit juridik	1				
5.1.3	E drejta e kundërvajtjes	1				
5.1.4	Kriminaliteti kompjuterik	1				
5.1.5	Viktimiologjia	1				
5.1.6	Psikologjia kriminalistike	1				
5.1.7	Kriminaliteti Ekologjik	1				
5.2	Ushtrime					
5.2.1	E drejta e procedures penale	1.5				
5.2.2	Metodologjia e shkrimit juridik	1.5				
5.2.3	Psikologjia kriminalistike	1.5				
5.2.4	Kriminaliteti Ekologjik	1.5				
5.2.5	E drejta e kundërvajtjes	1.5				
5.2.6	Kriminaliteti kompjuterik	1.5				
5.2.7.	Viktimiologjia	1.5				
6.	Mentor për mbrojtjen e temës në	3				

	ciklin e dytë	
7.	Anëtar komisioni për mbrojtjen e temës në ciklin e dytë	23
8.	Libër universitar i recenzuar pozitivisht	10
8.1.	Fatbardha Ismaili „Metodologjia e shkrimit juridik,, Tetovë 2019, ISBN978-608-66440-0-0, COBISS.MK-ID 111491850	10
9.	Libër i botuar dhe i përdorur në universitet jashtë vendit	8
9.1	Fatbardha Ismaili „Metodologjia e shkrimit juridik,, Tetovë 2019, ISBN978-608-66440-0-0, COBISS.MK-ID 111491850	8
10	Skriptë interne për ligjërime	20
10.1	Fatbardha Ismaili,„Metodologjia e shkrimit juridik,, 2015	1x4=4
10.2	Fatbardha Ismaili,„Metodologjia e hulumtimit shkencor,,2017	1x4=4
10.3	Fatbardha Ismaili,„E drejta e procedurës penale,, 2016	1x4=4
10.4.	Fatbardha Ismaili,„Kriminaliteti ekologjik,,2018	1x4=4
10.5.	Fatbardha Ismaili,„Psikologjia e kriminalitetit,,2020	1x4=4
	Totali i pikëve nga veprimtaria mësimore-arsimore	177.41

VEPRIMTARIA SHKENCORE-HULUMTUESE

Nr.	Emri i aktivitetit:	Pikët
1	Teza të mbrojtura	12
1.1	„Mjetet e jashtëzakonshme juridike në procedurën penale” Fakulteti Juridik Universiteti“Shën Kirili dhe Metodi” Shkup.	4
1.2	„ Zbatimi i masës së paraburgimit në aspekt të nenit 5 të Konventës Evropjane për të Drejtat e Njeriut” Fakulteti Juridik Universiteti“Shën Kirili dhe Metodi” Shkup.	8
2.	Pjesëmarrës në projekt ndërkombëtar shkencor	9
2.1.	International forum of teachers (IFT)	9
3.	Artikuj me rezultate shkencore origjinale, të publikuara në revistë referente shkencore/profesionale me bord redaktues ndërkombëtar	60

3.1.	F. Ismaili „Fair trial and its application in the Republic of Macedonia”, proceedings book ICSS 2015, volume II, Bucharest, 2015.	6
3.2.	F. Ismaili „Principle of reasonable time in criminal proceedings”, Academic journal of Justice and Law (AJJL), SKAP Journals, Slovakia 2015, impact factor 0.43, ISSN 1946-4699.	6
